

| | |
|--|---|
|  | REPUBLIKA KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA / KOSOVËS / VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE MINISTRY OF JUSTICE Nr.Br.No: 08-10599 Dati / Datum / Date: 20 / 11 / 2023 Shtojca / Dodaci / Annex PRISHTINË/A |
|--|---|



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministerstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.19/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore : lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P. nr. 771/2022, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha - Blakçori, pala ankuese , avokat nga personalisht Përmbaruesi Privat, me shumicë votash, me datën 13.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht e bazuar ankesa e palës , „ avokat nga ashtu që Organit Përmbarues - Përmbaruesi Privat , i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore , , është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkalim i autorizimit të besuar me ligj, ashtu që të njëjtë i shqiptohet masa disiplinore, vërejtje publike.

II. Hudhet si e palejuar, pjesa e kërkesës së palës ankuese . , nga , me të cilën ka kërkuar që të detyrohet Përmbaruesi Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore . t'ia kompensoi mjetet financiare, në shumën prej 212.40 euro.

A r s y e t i m

Pala ankuese me datë 10.08.2023, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divisionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ndaj përmbaruesit privat

me të cilën ka kërkuar që përmbaruesit privat ti shqiptohet masë disiplinore, pasi që me rastin e arkëtimit të shpenzimeve të procedurës si përfaqësues i kreditorit, nuk i janë bartur mjetet. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat shumën prej 212.40 euro, e ka vlerësuar si tarifë të efikasitetit, që në fakt sipas palës ankuese këto mjete është dashtë të arkëtohen nga kreditori, ngase përfaqësuesi nuk është përgjegjës për pagesën e tarifës së efikasitetit.

Më tutje pala ankuese ka kërkuar nga komisioni që të detyrohet përmbaruesi që t”a kompensoi në shumën prej 212.40 euro, mjete të cilat sipas palës ankuese kanë qenë shpenzime të procedurës të krijuara në këtë rast për përfaqësim të kreditorit, në rastin P. nr. 771/2022.

I ka propozuar komisionit që të pranohet në tërësi si e bazuar ankesa.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, me datë 10.08.2023, ka paraqitur në Komision Disiplinor Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, lidhur me veprimet e ndërmarra nga përmbaruesi privat në lëndën përmbarimore, P. nr. 771/2022, me propozim që të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me këtë rast.

Përmbaruesi privat, në përgjigjen e tij me shkrim dhe në seancën dëgjimore, e kundërshtoi në tërësi ankesën e palës ankuese si të pabazë, sepse mjetet financiare lëndore të arkëtuara në këtë rast janë shpenzime të krijuara dhe të arkëtuara për tarifën e efikasitetit e nuk janë shpenzime të krijuara nga përfaqësuesi i kreditorit që në rastin konkret është palë ankuese.

Në vazhdim përmbaruesi ka deklaruar se vetë kreditori që ishte i përfaqësuar nga pala ankuese në zyrën e përmbaruesit privat ia ka revokuar autorizimin palës ankuese, që me këtë rast edhe është përpiluar shënim i zyrtar, në të cilin është konstatuar se vet kreditori do ta zgjidh çështjen në mes të palës ankuese dhe kreditorit.

I ka propozuar komisionit që ankesa të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore vec e vec dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim se përmbaruesi privat, ka kryer shkelje disiplinore për çka rezulton se ankesa është pjesërisht e bazuar, për arsyet në vjim:

Komisioni Disiplinor gjen se përmbaruesi privat në këtë rast i ka tejkaluar autorizimet e tij, pasi nga mjetet e bllokuara të debitorit, te rasti P. nr. 771/2022, nuk i ka përbushur të gjitha shpenzimet e procedurës ndaj përfaqësuesit të kreditorit, si palë ankuese në këtë procedurë. Lidhur me tarifën e efikasitetit në shkallë prej 4%, siç është e përcaktuar, ishte dashur që përmbaruesi ti arkëtoi nga kreditori, e jo nga pala ankuese si përfaqësues i kreditorit, ku edhe vet përmbaruesi në

seancën dëgjimore ka dekluaruar se tarifa e efikasitetit duhet të paguhet nga kreditori. Nga arësyet e lart theksuara komisioni vlerësoi se përmbaruesi privat ka rënë ndesh me dispozitën ligjore të nenit 367, paragrafi 1 nën paragrafi 1 i LPP-së, në të cilin përcaktohet se: “*Nëse përmbaruesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj*” dhe me nënpagrin 2, të nenit dhe ligjit të lartcekur, në të cilin përcaktohet se: ”*nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij, përmbaruesi privat nuk i përbahet ligjet*”. Andaj komisioni vendosi si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor mori parasysh të gjitha rrëthanat e rastit, veçanërisht peshën e dëmit të shkaktuar ndaj palës ankuese, e cila ka ndikuar në lartësinë e masës së shqiptuar. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me vërejtje publike, bazuar në nenin 368, paragrafi 1, nën paragrafi 2 i LPP-së, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat e rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjtë do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve përmbarimore të përmbaruesi privat si dhe tek përmbaruesit tjere privat, që t'u përbahen dispozitave ligjore në përbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, edhe është qëllimi i masës.

Komisioni me rastin e vendosjes mori për bazë edhe pretendimin e përmbaruesit privat i cili theksoi në përgjegje në ankesë se debitori pjesërisht e ka paguar borxhin ndaj kreditorit dhe pjesërisht përmes llogarisë së përmbaruesit privat, ndërsa përmbaruesi privat nga pagesa lëndore, ka aplikuar nenin 16, pika 3 e Udhëzimit Administrativ, nr.01/2022, për Tarifat për Shërbimet dhe Kompensimet e Shpenzimeve për Përmbarues Privat. Këtë pretendim komisioni e vlerësoi si të qëndrueshëm dhe të bazuar në udhëzimin e lartcekur administrativ, mirëpo arkëtimi i tarifës së efikasitetit nuk duhet të bëhet nga mjetet e shpenzimeve të përfaqësuesit të kreditorit siç ka ndodhur në këtë rast, ngase përfaqësuesi i kreditorit si palë ankuese në këtë procedurë, nuk ka qenë në procedure te rasti, P.nr.771/2022, por ka qenë duke përfaqësuar interesin e kreditorit në atë procedurë, për këto arsyen edhe ky pretendim i përmbaruesit në këtë rast ka qenë pa ndikim në vendimmarrje ndryshe në këtë rast.

Komisioni me rastin e vendosjes, nuk u lëshua në vlerësimin meritor, të kërkesës së palës ankuese, që të detyrohet përmbaruesi lëndor, që t'ia kompensoi mjetet financiare, në shumën prej 212.40 euro, pasi që kjo nuk është nën juridiksionin e këtij komisioni që të vendos për këtë kërkesë, andaj vendosi si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi. Nëse pala ankuese edhe më tutje pretendon

në kërkesën e kësaj natyre, mund të inicon predurë tjetër për realizimin eventual të lidhur me pretendimet për këtë çështje.

Mbi bazën e të dhënavë si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 19/2023 datë 13.11.2023

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.